




GRATË POLITIKANE NË HAPËSIRËN DIGJITALE: ANALIZË E DISKURSIT ONLINE NË KOSOVË



GRATË POLITIKANE NË HAPËSIRËN DIGJITALE: ANALIZË E DISKURISIT ONLINE NË KOSOVË

(Janar – Prill 2026)

Prishtinë, 2026

Përgatitur nga: Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D)

Të drejtat e autorit ©2026. Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të shkurtra për qëllime kritike dhe rishikimi, asnjë pjesë e kësaj publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në çfarëdo sistemi të rikthimit të të dhënave, apo të transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti, qoftë elektronik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Ky raport u përgatit në kuadër të projektit “Mbështetje për Shoqërinë Civile në Kosovë”, i financuar nga Dukati i Madh i Luksemburgut dhe i implementuar nga LuxDev, Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor.

Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë patjetër pikëpamjet e Dukatit të Madh të Luksemburgut apo të individëve.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	3
Metodologjia	4
Ecuria mujore e raportimit dhe reagimeve në hapësirën digjitale	5
Analiza e përgjithshme e mbulimit të grave politkane (Janar – Prill 2026)	5
<i>Janar</i>	6
<i>Shkurt</i>	7
<i>Mars</i>	8
<i>Prill</i>	9
Analiza e fjalëve më të përdorura në komentet e publikut	10
Mbulimi mediatik i incidenteve ndaj grave në politikë.....	12
Zhvendosja e fokusit nga incidenti te përplasja politike	12
<i>Përdorimi i gjuhës etiketuesë ndaj grave të tjera politike</i>	<i>12</i>
<i>Ri-kornizimi i debatit përmes temave historike dhe identitare</i>	<i>12</i>
Rekomandime	14

Hyrje

Pjesëmarrja e grave në politikë dhe në jetën publike përbën një element thelbësor të demokracisë dhe të përfaqësimit të barabartë në proceset vendimmarrëse. Megjithëse në vitet e fundit është shënuar progres në rritjen e përfaqësimit të grave në institucionet publike dhe partitë politike në Kosovë, gratë vazhdojnë të përballen me sfida të shumta që ndikojnë në pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në jetën politike.

Zhvillimi i mediave online dhe rrjeteve sociale ka krijuar mundësi të reja për komunikim, informim dhe ndërveprim me publikun. Megjithatë, këto platforma kanë shërbyer gjithashtu si hapësira ku shpesh manifestohen sulme personale, gjuhë e urrejtjes, stereotipe gjinore dhe forma të tjera të komunikimit denigrues ndaj grave që ushtrojnë funksione publike. Në shumë raste, gratë politikane përballen me kritika që tejkalojnë debatin mbi qëndrimet apo performancën e tyre politike dhe fokusohen në gjininë, pamjen apo jetën e tyre personale.

Ky raport paraqet rezultatet e monitorimit të diskutimeve online dhe raportimit mediatik për gratë politikane në Kosovë gjatë periudhës janar–prill 2026. Analiza fokusohet në nivelin e ekspozimit publik të grave politikane, natyrën e diskutimeve të zhvilluara rreth tyre, si dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe formave të tjera të komunikimit denigrues në hapësirën digjitale.

Përmes analizës së përmbajtjeve mediatike, postimeve në rrjetet sociale dhe komenteve të publikut, raporti synon të identifikojë tendencat kryesore të diskursit publik ndaj grave në politikë, të evidentojë format më të shpeshta të sulmeve online dhe të kontribuojë në debatin publik mbi krijimin e një mjedisi më të sigurt, më gjithëpërfshirës dhe më të barabartë për pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe publike.

Gjetjet e raportit tregojnë se, ndonëse gratë politikane janë pjesë aktive e debatit publik dhe gëzojnë nivel të lartë të vëmendjes mediatike, ato mbeten objekt i një sasive të konsiderueshme komentesh fyese dhe sulmesh verbale në hapësirën digjitale. Kjo nënvizon nevojën për angazhim më të madh të institucioneve, mediave, partive politike, platformave digjitale dhe shoqërisë civile për të promovuar një kulturë komunikimi që respekton dinjitetin dhe pjesëmarrjen e barabartë të grave në jetën publike.

Metodologjia

Ky raport paraqet rezultatet e monitorimit të pranisë, perceptimit dhe trajtimit të grave politike në hapësirën digjitale gjatë periudhës janar–dhjetor 2026. Monitorimi është realizuar përmes platformës së inteligjencës mediatike dhe analizës së të dhënave **PIKASA**, e cila mundëson mbledhjen, klasifikimin dhe analizimin e përmbajtjeve nga media online dhe rrjetet sociale.

Monitorimi është fokusuar në profilet publike të grave politike në Kosovë, duke përfshirë bartëse të funksioneve ekzekutive, legjislative dhe partiake. Për secilën figurë të monitoruar janë analizuar përmendjet në media online, postimet në rrjete sociale, komentet e publikut dhe ndërveprimet e krijuara rreth tyre.

Të dhënat janë mbledhur në baza ditore gjatë gjithë periudhës së monitorimit dhe janë analizuar sipas indikatorëve kryesorë, si:

- Numri i përmendjeve dhe raportimeve mediatike;
- Numri i postimeve dhe diskutimeve në rrjetet sociale;
- Niveli i ndërveprimit të publikut (komente, reagime dhe shpërndarje);
- Prania e gjuhës së urrejtjes, sulmeve gjinore dhe përmbajtjeve denigruese;
- Temat dhe ngjarjet kryesore që kanë gjeneruar vëmendje publike;
- Tendencat mujore dhe periudhat me intensitet më të lartë të diskutimit.

Platforma PIKASA ka përdorur algoritme të analizës së tekstit për të identifikuar përmbajtje potencialisht fyese, seksiste ose të bazuara në gjini. Megjithatë, duke pasur parasysh kufizimet e analizës automatike, rezultatet janë verifikuar përmes shqyrtimit manual të rasteve më relevante, me qëllim të rritjes së saktësisë së klasifikimit.

Përveç analizës sasiore, raporti përfshin edhe një komponent cilësor, përmes së cilit janë shqyrtuar raste specifike të raportimit mediatik dhe diskutimeve online që kanë nxitur reagime të konsiderueshme publike. Kjo qasje ka mundësuar identifikimin e modeleve të komunikimit, narrativave dominuese dhe formave të sulmeve që prekin gratë në politikë.

Analiza mujore është ndërtuar mbi krahasimin ndërmjet vëllimit të raportimit mediatik dhe nivelit të angazhimit të publikut në rrjetet sociale, duke mundësuar identifikimin e ngjarjeve që kanë gjeneruar vëmendjen më të madhe publike gjatë vitit. Në këtë mënyrë, raporti ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të mënyrës se si gratë politike përfaqësohen, diskutohen dhe trajtohen në ekosistemin mediatik dhe digjital në Kosovë.

Ecuria mujore e raportimit dhe reagimeve në hapësirën digjitale

Analiza e përgjithshme e mbulimit të grave politikane (Janar – Prill 2026)

Gjatë periudhës janar–prill 2026, monitorimi identifikoi 135,528 komente në rrjetet sociale që lidhen me gratë politikane të përfshira në analizë. Nga këto, 13,123 komente janë klasifikuar si gjuhë e urrejtjes ose përmbajtje fyese, që përbën 10% të totalit të komenteve. Kjo tregon se një në dhjetë komente të publikuara për gratë politikane përmbante elemente të gjuhës denigruese, fyese ose stigmatizuese.

Figura 1: Ekspozimi i grave politikane ndaj komenteve dhe gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale (Janar–Prill 2026)



Analiza tregon se gratë me ekspozimin më të madh publik ishin njëkohësisht edhe më të ekspozuara ndaj komenteve negative. Albulena Haxhiu rezulton figura më e përmendur në diskutimet online, me 20,679 komente dhe 448 postime, duke reflektuar rolin e saj qendror në zhvillimet politike të periudhës së monitorimit. Megjithatë përqindja e komenteve të klasifikuara si gjuhë e urrejtjes ndaj saj (9%) është nën mesataren e përgjithshme, numri absolut i komenteve fyese mbetet i lartë, me 1,823 komente.

Ganimete Musliu paraqet një rast të veçantë, pasi regjistron 2,048 komente me gjuhë të urrejtjes, numrin më të lartë ndër të gjitha figurat e monitoruara. Me 14% të komenteve të klasifikuara si fyese, ajo renditet ndër figurat më të sulmuara në raport me vëllimin e diskutimeve publike.

Një nivel i lartë i gjuhës së urrejtjes vërehet edhe ndaj Vlora Çitakut dhe Fatmire Mulhaxha-Kollçakut, ku përqindja e komenteve problematike arrin në 15%, niveli më i lartë i regjistruar në mesin e figurave të monitoruara. Kjo nënkupton se afërsisht një në çdo shtatë komente të publikuara për këto figura përmbante elemente të gjuhës fyese ose denigruese.

Nga ana tjetër, figura si Mimoza Kusari-Lila, Arbërie Nagavci dhe Arijeta Fejza regjistrojnë përqindje më të ulëta të gjuhës së urrejtjes (7–8%), ndonëse edhe në këto raste numri i komenteve fyese mbetet i konsiderueshëm.


Të dhënat tregojnë gjithashtu se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet nivelit të ekspozimit publik dhe intensitetit të reagimeve online. Figurat që kanë gjeneruar më shumë postime dhe raportime mediatike kanë qenë edhe subjekt i numrit më të madh të komenteve, përfshirë komentet me përmbajtje fyese. Megjithatë, shkalla e gjuhës së urrejtjes nuk varet vetëm nga niveli i ekspozimit, pasi disa figura me më pak komente kanë regjistruar përqindje më të larta të përmbajtjes problematike.

Në përgjithësi, rezultatet e monitorimit tregojnë se gratë politike në Kosovë përballen me një nivel të konsiderueshëm të gjuhës së urrejtjes dhe sulmeve verbale në hapësirën digjitale. Diskursi publik karakterizohet nga polarizim i lartë politik, personalizim i debatit dhe përdorim i shpeshtë i gjuhës denigruese, duke krijuar një mjedis komunikimi që mund të ndikojë negativisht në pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në jetën politike dhe publike.

Janar

Muaji janar shënon nivelin fillestar të raportimit mediatik dhe diskutimeve publike për gratë në politikë dhe jetën publike në Kosovë. Gjatë javës së parë, vëllimi i raportimeve mbeti relativisht stabil, me ndërmjet 100 dhe 300 artikuj të publikuar në ditë. Kjo periudhë karakterizohet nga mbulim rutinor i aktiviteteve dhe deklaratave të figurave publike, pa ndonjë ngjarje të veçantë që do të dominonte agjendën mediatike.

Figura 2. Dinamika e artikujve, postimeve dhe ndërveprimeve publike gjatë janarit 2026



Një rritje e dukshme e raportimeve u regjistrua në mesin e muajit. Më 14 janar u shënuar niveli më i lartë i raportimit për këtë periudhë, me 431 artikuj të publikuar brenda një dite. Kjo rritje u nxit kryesisht nga diskutimet rreth zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës, e planifikuar për muajin mars, ku një pjesë e konsiderueshme e raportimeve dhe komenteve publike lidhej me Presidenten Vjosa Osmani. Paralelisht, vëmendje mediatike mori edhe dorëheqja e deputetes Hykmete Bajrami nga posti i nënkryetares së Lidhjes Demokratike të Kosovës.


Një zhvillim interesant u vërejt rreth datës 22 janar, kur ndërveprimet në rrjetet sociale tejkaluan vëllimin e raportimeve mediatike. Ky trend sugjeron se diskutimet online po zhvilloheshin në mënyrë të pavarur nga cikli tradicional i lajmeve, duke reflektuar një angazhim më të madh të publikut në debatet politike.

Në përgjithësi, të dhënat e janarit tregojnë se vëmendja publike u dominua nga lajmet e ditës dhe reagimet e menjëhershme në rrjetet sociale, ndërsa artikujt analitikë dhe opinionet mbetën në nivel relativisht të ulët gjatë gjithë muajit.

Shkurt

Krahasuar me janarin, gjatë muajit shkurt u regjistrua një rritje e ndjeshme e aktivitetit mediatik dhe e angazhimit të publikut. Java e parë mbeti relativisht e qetë, ndërsa në javën e dytë u shënuar një rritje e konsiderueshme e raportimeve dhe diskutimeve online.

Figura 3. Dinamika e artikujve, postimeve dhe ndërveprimeve publike gjatë shkurtit 2026



Piku i muajit u arrit më 11 shkurt, me 803 artikuj të publikuar. Ndryshe nga periudhat e tjera, në këtë rast niveli i ndërveprimit të publikut ishte pothuajse proporcional me vëllimin e raportimit, duke treguar interes të lartë publik për temat e trajtuara. Diskutimet u dominuan nga zhvillimet që lidhen me procesin e konstituimit të institucioneve dhe zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit, ku Albulena Haxhiu ishte ndër figurat më të përmendura.


Një tjetër rritje e aktivitetit u regjistrua më 17 shkurt, në kuadër të shënimit të përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Megjithëse numri i publikimeve ishte i lartë, niveli i ndërveprimit në rrjetet sociale rezultoi dukshëm më i ulët sesa më 11 shkurt. Kjo tregon se zhvillimet politike të lidhura me formimin e institucioneve gjeneruan më shumë interes publik sesa aktivitetet ceremoniale dhe përkujtimore.

Ngjashëm me muajin paraprak, diskutimet online u karakterizuan nga reagime të shpejta ndaj zhvillimeve aktuale, ndërsa përmbajtjet analitike dhe opinionet vazhduan të kenë ndikim të kufizuar në debatet publike.

Mars

Muaji mars shënoi nivelin më të lartë të raportimit mediatik dhe angazhimit publik gjatë gjithë periudhës së monitorimit. Rritja e vëmendjes publike për çështjet që lidhen me gratë në politikë përkoi me periudhën kur në nivel ndërkombëtar shtohen diskutimet mbi të drejtat dhe përfaqësimin e grave në jetën publike.

Figura 4. Dinamika e artikujve, postimeve dhe ndërveprimeve publike gjatë marsit 2026



Brenda ditëve të para të muajit u regjistrua një rritje e ndjeshme e raportimeve. Piku u arrit më 5 dhe 6 mars, kur u publikuan 1,395 artikuj brenda 24 orëve. Kjo periudhë u shoqërua me mbi 20,000 ndërveprime në rrjetet sociale, duke përfaqësuar nivelin më të lartë të angazhimit publik të regjistruar gjatë monitorimit.


Temat dominuese lidhen me procesin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës dhe debatet politike rreth mundësisë së kandidimit të Vjosa Osmanit për një mandat të ri. Përmbajtja e raportimeve përbëhet kryesisht nga deklarata të partive politike, reagime të akterëve institucionalë dhe zhvillimet parlamentare të lidhura me këtë proces.

Të dhënat tregojnë se çështjet që lidhen me pozitat më të larta shtetërore dhe përfaqësimin e grave në institucione vazhdojnë të gjenerojnë interes të konsiderueshëm mediatic dhe publik.

Prill

Muaji prill karakterizohet nga një dallim më i theksuar ndërmjet ritmit të raportimit mediatic dhe interesit të publikut në rrjetet sociale. Gjatë tri javëve të para, numri i përmendjeve dhe raportimeve ditore luhatej ndërmjet 200 dhe 600 publikimeve, pa një temë të vetme dominuese.

Figura 5. Dinamika e artikujve, postimeve dhe ndërveprimeve publike gjatë prillit 2026



Një ndryshim i dukshëm u regjistrua gjatë javës së fundit të muajit. Rreth datës 24 prill, ndërveprimet në rrjetet sociale arritën nivelin më të lartë të muajit, ndonëse raportimi mediatik mbeti relativisht i kufizuar. Kjo lidhej kryesisht me debatet dhe spekulimet publike rreth procesit të zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës, të cilat fillimisht u zhvilluan në rrjetet sociale përpara se të reflektoheshin në raportimet e mediave.

Piku i raportimit mediatik u arrit më 28 prill, me 1,138 artikuj të publikuar brenda një dite. Vëmendja mediatike u fokusua kryesisht te emrat e përmendur si kandidatë potencialë për postin e Presidentit, veçanërisht Feride Rushiti dhe Vjosa Osmani. Një pjesë e konsiderueshme e raportimeve përbëhej nga deklarata dhe reagime të figurave politike, të cilat u riprodhuan gjërësisht nga mediat online.

Në tërësi, muaji prill dëshmon një rol gjithnjë e më aktiv të rrjeteve sociale në formësimin e debatit publik, ku diskutimet online në disa raste paraprijnë dhe ndikojnë agjendën e raportimit mediatik.

Analiza e fjalëve më të përdorura në komentet e publikut

Analiza e reve të fjalëve (word cloud) të gjeneruar nga komentet e publikut në rrjetet sociale tregon një nivel të lartë të gjuhës fyese, denigruese dhe stigmatizuese ndaj grave në politikë. Fjalët më të shpeshta të identifikuara përfshijnë terma si "haj*", "trad*tar", "krimin*!", "buda*", "analfabet", "mu*", "hajva*", "shki*", "rren*" dhe "lo*", të cilat dominojnë diskursin online.

Mbulimi mediatik i incidenteve ndaj grave në politikë

Zhvendosja e fokusit nga incidenti te përplasja politike

Përveç analizës së diskutimeve në rrjetet sociale, monitorimi ka shqyrtuar edhe mënyrën se si mediat online raportojnë për incidentet që përfshijnë gra në politikë. Një nga rastet e analizuara lidhet me raportimin e një serie artikujsh të publikuar pas incidentit ndaj deputetes Vlorë Çitaku.

Analizat tregojnë se, megjithëse raportimi fillestar e trajton incidentin si sjellje të papranueshme dhe fyese, mbulimi pasues gradualisht e zhvendos fokusin nga vetë incidenti dhe implikimet e tij për gratë në politikë drejt debateve më të gjera partiake dhe politike. Në këtë proces, diskutimi largohet nga çështjet e seksizmit, etikës së komunikimit publik dhe standardeve të sjelljes së përfaqësuesve politikë.

Përdorimi i gjuhës etiketuesë ndaj grave të tjera politike

Në disa prej artikujve të analizuar vërehet përdorimi i gjuhës etiketuesë ndaj figurave të tjera politike gra. Për shembull, përdorimi i shprehjeve si "*partizania e X partie*" nuk kontribuon në një debat substancial mbi çështjet politike apo institucionale, por përqendrohet te karakterizimi personal dhe identifikimi partiak i personit në fjalë.

Kjo qasje krijon një kontrast të dukshëm mes dënimit të gjuhës fyese në një rast dhe përdorimit të formave të tjera të diskursit denigrues në raportimet pasuese. Si rezultat, vëmendja zhvendoset nga problematika e seksizmit dhe diskriminimit gjinor drejt përplasjes politike ndërmjet akterëve të ndryshëm.

Ri-kornizimi i debatit përmes temave historike dhe identitare

Analiza identifikon gjithashtu raste kur incidenti fillestar ri-kornizohet përmes referencave ndaj çështjeve historike dhe identitare, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me ngjarjen në fjalë. Përmes përfshirjes së temave që ngjallin polarizim politik dhe emocional, debati publik zhvendoset nga shqyrtimi i sjelljeve problematike ndaj grave në politikë drejt narrativave më të gjera ideologjike dhe partiake.

Kjo mënyrë raportimi mund të ndikojë në zbehjen e diskutimit mbi përgjegjësinë individuale dhe institucionale për gjuhën fyese apo diskriminuese, duke e orientuar vëmendjen e publikut drejt çështjeve të tjera që nuk lidhen drejtpërdrejt me incidentin fillestar.

Rasti i analizuar tregon se një pjesë e mediave online priren ta trajtojnë incidentin fillestar si pikënisje për debate më të gjera politike, në vend që të fokusohen vazhdimisht te aspektet që lidhen me diskriminimin gjinor, gjuhën seksiste apo ndikimin e këtyre sjelljeve në pjesëmarrjen e grave në jetën publike.

Si pasojë, rastet e misogjinisë apo sulmeve ndaj grave politike shpesh rrezikojnë të instrumentalizohen brenda rivaliteteve partiake, ndërsa diskutimi mbi barazinë gjinore,

Gratë politikane në hapësirën digjitale: Analizë e diskursit online në Kosovë

respektin në diskursin publik dhe mbrojtjen e dinjitetit të grave mbetet në plan të dytë. Kjo tregon nevojën për raportim më të qëndrueshëm dhe më të fokusuar në dimensionin gjinor të këtyre incidenteve, përtej interesave të momentit politik.

Rekomandime

1. **Të forcohen mekanizmat e llogaridhënies së mediave** përmes promovimit të standardeve etike të raportimit dhe shmangies së amplifikimit të narrativave misogjene dhe sulmeve të bazuara në gjini.
2. **Të rriten kapacitetet e monitorimit dhe reagimit të institucioneve përkatëse**, përfshirë organet rregullatore, organizatat për verifikimin e fakteve dhe organizatat e shoqërisë civile, me qëllim të identifikimit dhe adresimit më efektiv të dezinformatave me bazë gjinore.
3. **Të avancohen programet e edukimit medial dhe digjital**, për të ndihmuar qytetarët të identifikojnë përmbajtjet e manipuluar, stereotipet gjinore dhe fushatat dezinformuese që synojnë gratë në jetën publike.
4. **Të inkurajohen partitë politike dhe institucionet publike** që të miratojnë dhe zbatojnë kode të qarta të sjelljes, të cilat dënojnë gjuhën seksiste, ngacmimin online dhe sulmet me bazë gjinore nga zyrtarët publikë dhe përfaqësuesit politikë.
5. **Të përmirësohet bashkëpunimi me platformat e rrjeteve sociale** për të mundësuar raportim më të shpejtë dhe largim më efikas të përmbajtjeve që promovojnë gjuhën e urrejtjes, ngacmimin apo dezinformimin me bazë gjinore.
6. **Të krijohen dhe forcohen mekanizmat mbështetës për gratë në jetën publike**, duke përfshirë ndihmën juridike, mbështetjen psikologjike dhe trajnimet për sigurinë digjitale, me qëllim të zbutjes së ndikimit të abuzimit online.
7. **Të promovohen narrativa pozitive dhe përfaqësimi i barabartë i grave në media dhe në diskursin publik**, në mënyrë që të kundërshtohen stereotipet e dëmshme dhe të kontribuohet në krijimin e një mjedisi demokratik më gjithëpërfshirës dhe më të barabartë.

